



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

Shtojca 11.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

[19.08.2025]

Drejtuar: *[MEKTRIN MOTORS , NIPT:K51408501P, Adresa:Durres, Shijak Autostrada “Durres – Tirane”, Km 6, Xhafzotaj DURRES Nr Pasurise 16/22 Zona Kadestrale 3852]*

Operatorit Ekonomik (OE)

MEKTRIN MOTORS , NIPT:K51408501P

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) nuk esht bashkim operatorësh

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur mbi kufirin e larte monetar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **REF- 52968-07-01-2025**
[“Blerje Automjetesh ” Për nevojat e Shoqerisë Illyrian Guard Loti 2 Blerje Automjetesh/SUV
4+1 , REF-52978-07-01-2025] kohëzgjatja e kontratës: jo me shume se 90 dite nga nenshkrimi
kontrates]

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 01.07.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Buletini Nr. 34 datë 7 Korrik
2025].

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm
me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ALBANIA MOTOR COMPANY

Numri i NIPT-t :K41829010I

Vlera 51,100,000 (Pesedhjetë e një milion e njëqind mijë leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. MEKTRIN MOTORS

Numri i NIPT-it: K51408501P

Vlera 49,140,000 (Dyzet e nente milion e njëqind e dyzet mijë leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. PORSCHE ALBANIA SH.P.K

Numri i NIPT-it: K51914014P

Vlera 0 Leke

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Tirana Auto

Numri i NIPT-it: K82318007Q

Vlera 52,010,000 (Pesedhjetë e dy milion e dhjetë mijë leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5.CompiTEL

Numri i NIPT-it: M31417021V

Vlera : 49,000,000 (dyzet e nente milion Leke pa TVSH)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ALBANIA MOTOR COMPANY

Numri i NIPT-t :K41829010I

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e mëposhtme te skualifikimit:

Ofertuei skualifikohet pasi personi i cili ka firmosur vetëdeklarimin sipas shtojcës 9, deklaratat si dhe formularin e ofertës ekonomike nuk ka prokurë të posaçme kjo në kundërshtim të neneve 64 dhe 70 e në vijim të Kodit Civil si dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 i ndryshuar.

Ofertuesi nuk përmbush pikën 1 (a) të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi formulari i përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është mbushur në mënyrë të plotë duke mos dhënë informacionin e kërkuar, konkretisht ofertuesi nuk ka plotësuar, paraqitur emrat e administratorit, ortakëve të cilat figurojnë në ekstrakin e QKR-së. Kjo në kundërshtim me pjesën II “Shkaqet e përjashtimit”, pika A “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” të “Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit” i cili detyron çdo ofertues të mundshëm të deklarojë emrat e personave të cilët në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP me vendimin nr .672/2024 datë 12.06.2024 i cili citon se:

“Në rastin konkret Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues “Lidhri Dyrrahu” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, shtojca 9 e DST, verihet se operatori ekonomik “Lidhri Dyrrahu” SHPK nuk ka përcaktuar adresat e web-it, për verifikimin/evidencimin e autoritetit, që lëshon dokumentacionin provues ndaj deklarimeve të kryera në Formularin e Vetëdeklarimit.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për të cilin duhet të përcaktonte adresat e web-it.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP.

Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues “Lidhri Dyrrahu” SHPK nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të formularit të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat që ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës”.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP me vendimin nr. 403, datë 14.05.2018

Objekti: Ankim i operatorit ekonomik “Kostandin Group” sh.p.k. kundër vendimit të KVO-së mbi skualifikimin nga procedura e prokurimit “Loti IX – Blerje automjete për SHCBA-në”, zhvilluar më datë 10.04.2018, me fond limit 17.717.700 lekë pa TVSH, Autoritet Kontraktor – Ministria e Brendshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KPP konstaton se personi që ka firmosur ofertën ekonomike dhe deklaratat shoqëruese (Z. Bledi Llazari) nuk ka pasur tagrin ligjor për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në momentin e dorëzimit të ofertës, pasi afati i emërimit të tij si administrator kishte përfunduar më datë 31.03.2018 dhe nuk ishte paraqitur asnjë dokument që provonte riemërimin ose autorizimin (p.sh. prokurë e posaçme ose vendim i Asamblesë së Ortakëve) në momentin e dorëzimit të ofertës (10.04.2018).

KPP vlerëson se operatori ekonomik kishte detyrimin të provonte me dokumente në datën e dorëzimit të ofertës vlefshmërinë e tagrit të përfaqësimit dhe mungesa e këtij dokumentacioni justifikon skualifikimin. Dorëzimi i dokumenteve pas datës së hapjes së ofertave nuk mund të merret në konsideratë.

Në përputhje me nenet 12 dhe 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Shtojcën 9 të dokumenteve të procedurës, mungesa e prokurës së posaçme ose vendimit të vlefshëm të organit drejtues për përfaqësim ligjor përbën mospërmbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. - Faza: Kriter i përgjithshëm

Arsyet e skualifikimit:

Ofertuesi nuk përmbush pikën 1 (b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës, kjo në kundërshtim të nenit 83 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili citon “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Ofertuesi nuk plotëson pikën 2.3.2, Mungojnë në Autorizimin nga prodhuesi të dhëna si : tel, fax, email, website.

2.3.6 Ka paraqitur kontratën e qirasë për servisin, por nuk ka dorëzuar fotografite të kërkuara të ambientit të servisit, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

Ofertuesi nuk plotëson pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, Konkretisht, në dokumentacionin teknik mungon përputhshmëria e plotë për përmasat e mjetit, veçanërisht gjerësia, e cila nuk përmbush kriterin minimal të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. - Faza: Kriter i përgjithshëm

3. PORSCHE ALBANIA SH.P.K

Numri i NIPT-it: K51914014P

Arsyet e Skualifikimit:

Nuk ka paraqitur asnjë dokument

Faza: Kriter i përgjithshëm

Faza: Vleresim Teknik

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4..CompiTEL

Numri i NIPT-it: M31417021V

Arsyet e Skualifikimit:

2.3.2 Mungon Autorizimi nga prodhuesi.

Ofertuesi nuk plotëson pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk përputhet me specifikimet e kërkuara. Konkretisht, çertifikata e konformitetit (CoC) nuk është në përputhje me katalogun teknik të sjellë nga operatori ekonomik, duke krijuar mospërputhje në të dhënat teknike të mjetit.

Gjithashtu, të dhënat e paraqitura për fuqinë motorike dhe distancën aksiale nuk përputhen me kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke rezultuar jashtë kriterëve minimale të pranueshme. - Faza: Kriter i përgjithshëm

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [MEKTRIN MOTORS , NIPT:K51408501P, Adresa:Durres, Shijak Autostrada “Durres – Tirane”, Km 6, Xhafzotaj DURRES Nr Pasurise 16/22 Zona Kadestrale 3852], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera 49,140,000 [Dyzet e nente milion e njeqind e dyzet mije leke pa TVSH] / është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Njesia E prokurimit